



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**SHOQATA
“OPEN MIND SPECTRUM
ALBANIA (OMSA)”**



**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

Nr. 1 Prot, datë 10.05.2013

Nr. 318 Prot, datë 10.05.2013

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DHE
SHOQATA “OPEN MIND SPECTRUM ALBANIA (OMSA)”**

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, si institucion shtetëror i cili funksionon në bazë të ligjit Nr. 10 221, datë 14.02.2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, që këtu e më poshtë do të referohet si Komisioneri (Pala);

SHOQATA “OPEN MIND SPECTRUM ALBANIA (OMSA)”, si person juridik, regjistruar me Vendimin Nr. 804 datë 05/04/2013 të Gjykatës të Shkallës të Parë, Tiranë, që këtu e më poshtë do të referohet si (Palë);

Duke qënë se Komisioneri është institucioni që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin;

Duke qënë se Shoqata “OPEN MIND SPECTRUM ALBANIA (OMSA)”, e cila është një organizatë jo qeveritare që e bazon veprimtarinë e saj në parimin e respektimit, mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave të njeriut, të parashikuara në Kushtetutën e Republikës të Shqipërisë, ligjet dhe marveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj. Mbrotja e të drejtave të tyre me qëllim integrimin e tyre në shoqëri, gjithashtu do të ndihmojë për të rritur dukshmërinë e komuniteteve të caktuara si ai: Rom, Egjyptian (dhe të gjithë grupimeve të tjera me ngjyrë në Shqipëri); të personave LGBTQI (Lesbik, Gej, Biseksual, Transgjinor, Queer, Intersex); të adoleshentëve dhe më të rritur; nënave në nevojë e që i përkasin këtyre shtresave shoqërore; të të rinjve me probleme të caktuara shëndetësore, si droga dhe sida etj; grave; dhunës në familje; barazisë gjinore dhe mos diskriminimin; mbrojtjen e të drejtave të këtyre komuniteteve në strukturat e drejtësisë dhe sigurimi i asistencës juridike ndaj tyre nëpërmjet një stafi të kualifikuar për këto cështje; duke rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë shqiptare mbi problematikat e tyre, duke rritur nivelin e informimit të publikut dhe institucioneve mbi çështjet që shqetësojnë këto komunitete pa cënuar dispozitat ligjore.

Me synimin e përbashkët për respektimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

Me objektiv garantimin e te drejtave dhe lirive themelore te njeriut, sigurimin e të drejtës së çdo personi për, brarazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë, për mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, për personat;

Me angazhimin për të asistuar njeri-tjetrin mbi parimin e reciprocitetit, dhe me bindjen se bashkëveprimi është në ndihmën dhe interesin e qytetarëve;

Palët,

Bien dakort si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

- 1.1 Kjo marrëveshje ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe modaliteteve brenda të cilave Palët do të zhvillojnë, marrëdhëniet ndërmjet tyre, për marrjen e masave për mbrojtjen nga diskriminimi.

Neni 2

Angazhimet e paleve dhe format e bashkëpunimit

- 2.1 Palët do të bashkëpunojnë për ofrimin e një shërbimi të plotë ligjor për të gjithë personat, që paraqesin ankesa pranë tyre, i cili do të përfshijë ndihmën për zgjidhjen e problemeve në organet e administratës shtetërore dhe shërbimin e plotë ligjor për zgjidhjen e problemeve jashtëgjyqësish.
- 2.2 Komisioneri angazhohet të bashkëpunojë me Shoqatën “OPEN MIND SPECTRUM ALBANIA (OMSA)” për rastet e personave të cilët kanë nevojë për asistencën e Komisionerit gjatë proceseve gjyqësore apo për fillimin e procesit gjyqësor, për rastet kur konstatohet diskriminim.
- 2.3 Palët angazhohen të bashkëpunojnë në organizimin e fushatave të përbashkëta sensibilizuese dhe trajnimeve, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen nga diskriminimi, minimizimin e rasteve të diskriminimit, mbrojtjen e të drejtave të personave, përmirësimë e situatës ligjore të tyre në lidhje me diskriminimin;
- 2.4 Palët angazhohen të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë ekspertize për përmirësimin e legjislacionit ekzistues, me qëllim përfshirjen e masave të reja që garantojnë trajtimin e barabartë dhe eleminimin e parashikimeve diskriminuese nga legjislacioni aktual në fushën e aftësisë të kufizuar, romët dhe egjiptianët, personat LGBT etj. nëpërmjet propozimeve dhe rekomandimeve në funksion të mbrojtjes të të drejtave;
- 2.5 Palët do të informojnë njëra-tjetrën mbi çdo lloj shërbimi që ata do të ofrojnë në të ardhmen në bashkëpunim dhe mbi çdo gjë tjetër që do të gjykohet e nevojshme për një bashkëpunim të frytshëm midis palëve të kësaj marrëveshjeje;
- 2.6 Palët do të udhëhiqen gjithnjë dhe mbi të gjitha nga interesi i qytetarëve të cilët kanë nevojë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe problemeve të tyre, me qëllim që ato të zgjidhen në mënyrën më të përshtatshme;
- 2.7 Palët angazhohen të mbështesin njëra tjetrën në realizimin e veprimtarive të përbashkëta me interes reciprok;
- 2.8 Palët do të bashkëpunojnë edhe në forma të tjera të bashkëpunimit për të cilat mund të bihet dakort në të ardhmen.

Neni 3

Komunikimi i Palëve

3.1 Palët komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme ndërmjet tyre dhe shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore.

3.2 Palët do të caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

3.3 Personat e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin e veprimeve me palën tjetër.

Neni 4
Dispozita të Fundit

4.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet për një afat të pacaktuar dhe ajo do të jetë efektive për sa kohë do të gjykohet si i nevojshëm dhe i domosdoshëm bashkëpunimi midis palëve.

4.2 Çdo palë mund të kërkojë zgjidhjen e marrëveshjes, duke njoftuar palën tjetër 30 ditë para.

4.3 Marrëveshja mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të paraqitur me shkrim.

4.4 Palët në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi do të bëjnë të gjitha përpjekjet për ekzekutimin sa më efektiv të të gjitha detyrimeve të marra përsipër prej tyre.

4.5 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj.

4.6 Kjo marreveshje bashkëpunimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale, dy për secilën palë.

Nënshkruar në Tiranë, më 10/05/2013.

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN


NGA DISKRIMINIMI



Irma BARAKU



**“OPEN MIND SPECTRUM ALBANIA
(OMSA)”**


Arbëri KODRA